



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 7, datë 12.02.2015

Për

“EMËRTIMIN E NJË PREJ RRUGËVE TË QYTETIT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 8/VII, gërma “b” dhe nenit 32, gërma “ll” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neni 31 i “Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak”; nenit 8, 121, 124, 125, 126 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (i ndryshuar); nenit 3 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 për “Sistemin e adresave” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë së Tiranës,

V E N D O S I:

1. Të miratojë emërtimin e një prej rrugëve të qytetit të Tiranës, me emërtimin “Kuvajt” të segmentit rrugor nga “Ruga e Xibrakëve” deri tek restoranti “Xibraku”, me gjatësi 440 m.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit si dhe Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për zbatimin e këtij vendimi.
- 3 Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI